

Platforma për zgjedhjet lokale 207

Pse OBKD do të marrë pjesë në kept zgjedhje lokale.

Ne si OBKD konsiderojmë që motori i zhvillimit ekonomik në Kosovë arrihet përmes bujqësisë dhe turizmit.

Ne do të japim alternativat tona, gjithmonë duke pasur parasysh që të mendojmë të realizojmë sa më shumë eksport të produkteve bujqësore etj.

Në këtë pikë ne do të fokusohemi në disa pika si:

Shfrytëzimi i resurseve natyrore të komunës, tokave bujqësore, kullosave, pyjeve etj.

- Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, bletarisë etj.
- Formimi grupeve të eksperteve të fushave përkatëse, planifikimi dhe ndihma e këtij grupi ndaj Fermerëve, Blegtorëve, Bletarëve dhe fushave tjera.
- Ndërlidhja dhe garantimi i produkteve bujqësore, të blegtorisë, bletarisë etj. Grupi punues të cilët do të merren me hulumtimin, njoftimin e qytetarëve për mundësitë e zhvillimit si në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë etj. Ky grup gjithashtu do të identifikoj të gjitha pronat që mund të përdoren për bujqësi, blegtori, bletari etj. dhe do të ndërmjetësoj në mes të atij personi që ka tokë bujqësore por nuk e punon apo s'ka mundësi ta punoj dhe atij që nuk ka tokë por ka vullnet dhe ka mundësi ta punoj, do t'i ndihmoj në planifikim, projektim dhe brenda mundësive buxhetore edhe do të subvencionohen.
- Subvencionet për keto lëmi do të rriten gradualisht.

Parashohim dyfishim të buxhetit për këto kategori që në vitin e parë.

Kosova ka bukuri të rralla natyrore dhe vendi ynë ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit në gjithë Kosovën, që do të ishte ndihmesë e madhe për zhvillim ekonomik.

